



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- B1 Prezantimi dhe shpalosja e regjistrit të pasurive kapitale në PFV ishte nënvlerësuar për 8,415,650€, ndërsa regjistri i pasurive jokapitale ishte nënvlerësuar për 662,078€ si pasojë e mos regjistrimit të pasurive dhe klasifikimit të gabuar në regjistra.
- B2 Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerë 3,857,681€ duke ndikuar në mbivlerësimin/ nënvlerësimin e kategorive ekonomike adekuate.
- A1 Buxheti fillestar dhe final i të hyrave në Pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ishte nënvlerësuar për 1,048,801€, për shkak të prezantimit jo të drejtë të informatave mbi buxhentin.
- B3 Si rezultat i mungesës së vlerësimit jo të duhur financiar dhe mos përditësimit të regjistrit, detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 233,634€.
- A2 Stoku farmaceutik i shpalosur në PVF ishte mbivlerësuar për shkak të përfshirjes së artikujve me afat të skaduar në vlerë 58,154€.
- B4 Në Spitalin e Prizrenit pasuria "Kombi Bus-4 dyer" figuronte në regjistrat e pasurisë, por nuk është arritur të konfirmohet ekzistenca e saj fizike.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A3 Nëntë (9) pozita të nivelit drejtues mbahen me ushtrues detyre jo në përputhje me dispozitat ligjore.
- B5 Vonesa nga pesë (5) deri në 86 ditë në pagesën e faturave në vlerë prej 5,890,791€
- A4 Në katër (4) pagesa për blerje të aparaturave mjekësore në vlerë të përbashkët prej 927,200€, janë evidentuar vonesa në liferimin e mallrave nga tre (3) deri në 52 ditë, përtej afateve të përcaktuara kontraktuale.
- A5 Dhënia e avansit për investime kapitale në vlerë prej 341,502€ përtej limiteve të përcaktuara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë menaxhimi i pasurive me theks të veçantë regjistrimi i plotë dhe i saktë i pasurive kapitale dhe jo kapitale, klasifikimi adekuat i shpenzimeve si dhe prezantimi i drejtë i shpalosjeve në pasqyra financiare.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet shmangies së vonesave në ekzekutimin e pagesave si dhe mbajtjes së pozitive të nivelit drejtues me ushtrues detyre përtej afateve ligjore.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, si dhe shtatë (7) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Nënvlërësimi i regjistrave të pasurive në PFV si pasojë e mangësive në regjistrimin dhe mbajtjen e tyre

##### Gjetja

Sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6.3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 10 i së njëjtës rregullore parasheh se të gjitha pasuritë jo financiare, pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht nëse janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe vlerësimit. Njëheri, neni 22 i kësaj rregullore përcakton normat e zhvlerësimit si dhe llogaritjen bazuar në natyrën e pasurisë.

Nga mangësitë e identifikuar lidhur me mbajtjen e regjistrave të pasurive, ka rezultuar se vlera e pasurisë kapitale në regjistra ishte nënvlerësuar për 8,415,650€ (e ndikuar nga nënvlerësimi prej 8,866,398€ dhe mbivlerësimi prej 450,750€), ndërsa regjistri i pasurisë jokapitale ishte nënvlerësuar për 662,078€.

Më detajisht, regjistri i pasurisë kapitale ishte nënvlerësuar si rezultat i mos regjistrimit të pasurive kapitale për 8,866,398€ si dhe pasurive jo kapitale për 662,078€ si në vijim:

- Pasuritë e blera lidhur me kontratën "Furnizimi me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik", të pashpërndara të përfutuesit deri në fund të vitit ishin në vlerë 6,293,374€ (nga të cilat pajisje mbi 1,000€ ishin në vlerë 5,631,296€ dhe pajisje nen 1,000€ ishin në vlerë 662,078€). Të njëjtat nuk figuronin të regjistruara në asnjërin regjistër të pasurive;

- Mosregjistrimit të pagesave të vitit në lidhje me projektet: “Modernizimi i infrastrukturës së SHSKUK” - tri pagesa në vlerë të përbashkët 2,385,431€, “Adaptimi i koridoreve të QKUK-së”- një pagesë në vlerë 84,699€, “Renovimi dhe riorganizimi i reparteve Pediatri dhe Interno - Spitali i Përgjithshëm Prizren” - një pagesë në vlerë 341,502€”, si dhe
- Regjistrimi i pjesëshëm i tri faturave të vitit në vlerë të përbashkët 752,750€, duke mbetur pa u regjistruar pasuri në vlerë 423,470€.

Ndërsa, regjistri i pasurive kapitale ishte mbivlerësuar si rezultat i klasifikimit të gabuar të pasurive në vlerë 450,750€ si në vijim:

- Tri pajisje mjekësore të blera në vitin 2008 janë klasifikuar me jetëgjatësi 40 vite si objekte shëndetësore, në vend se të ishin regjistruar me jetëgjatësi pesë (5) vite si pajisje mjekësore, duke mbivlerësuar regjistrin e pasurive për 348,767€;
- 19 frigoriferë medicinal (300L), të blerë në vitin 2019, janë klasifikuar si objekte shëndetësore me jetëgjatësi 40 vite, në vend se të ishin regjistruar me jetëgjatësi pesë (5) vite si pajisje mjekësore, duke mbivlerësuar regjistrin e pasurive për 23,750€;
- Regjistri ishte mbivlerësuar për shkak mbajtjes gabimisht të pajisjes dhe projekteve që kane pranim teknik, në klasën “investime ne vijim” duke mos u aplikuar zhvlerësimi, si në vijim: Një pajisje mjekësore e blerë në vitin 2021 me vlerë blerëse 33,400€ ka mbivlerësuar regjistrin e pasurive për 32,287€; dy pagesa në vlerë 176,115€ për projektin e ndërtimit të Ambulancave Specialistike, pranimi teknik ishte realizuar në dhjetor 2019, ka mbivlerësuar regjistrin e pasurive për 26,417€; si dhe tri pagesa në vlerë 312,458€ për projektin e Kardiologjisë në Prizren pranimi teknik ishte realizuar në dhjetor 2023, ka mbivlerësuar regjistrin e pasurive për 19,529€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos efikasitetit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive, përfshirë procesin ndërmjet pranimit të pasurive dhe regjistrimit të tyre në sistemet përkatëse (SIMFK dhe e-pasuria). Po ashtu, mos koordinimit të duhur ndërmjet njësive përgjegjëse (prokurimi, pranimi dhe financa), si dhe moszbatimim i plotë i kërkesave të rregullores për regjistrimin me kohë të pasurive.

#### **Ndikimi**

Mosregjistrimi i pasurive të blera gjatë vitit, parregullsitë në klasifikimin e pasurive dhe aplikimin e normave jo të duhura të zhvlerësimit kanë ndikuar në paraqitjen jo të drejtë dhe jo të vërtetë të informatave në PFV. Kjo dobëson besueshmërinë e raportimit financiar dhe rrit rrezikun për keqmenaxhim dhe mungesë të kontrollit mbi pasuritë publike.

#### **Rekomandimi B1**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollet e duhura dhe koordinim adekuat ndërmjet njësive përgjegjëse të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve****Gjetja**

Rregulla financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, neni 18 paragrafi 3 përcakton se shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël, neni 11, kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë udhëzim. Ndërsa Udhëzuesi i Planit Kontabël Dhjetor 2023 specifikon saktësisht regjistrimin e shpenzimeve në të gjitha kodet ekonomike.

Gjatë vitit janë ekzekutuar pagesa në vlerë totale prej 3,857,681€ nga kategori ekonomike që nuk përkojnë me natyrën e shpenzimeve. Nga kjo vlerë, 3,663,653€ janë paguar nga kategoria e investimeve kapitale dhe 194,028€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ky keqklasifikim ka ndikuar në prezantimin e pasaktë të shpenzimeve në PFV, si në vijim:

- Dy pagesa në vlerë totale prej 2,592,587€ për furnizime me produkte për personat paraplegjik dhe tetraplegjik janë klasifikuar si investime kapitale, ndonëse i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve;
- Në tre pagesa nga për pajisje mjekësore në kategorinë e kapitaleve, vlera prej 906,657€ i përket pajisjeve me vlerë nën 1,000€, të cilat do të duhej të ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
- Shtatë pagesa në vlerë totale prej 319,357€ (nga të cilat 154,948€ nga mallrat dhe shërbimet dhe 164,409€ nga investimet kapitale) janë ekzekutuar sipas vendimeve gjyqësore përmes Thesarit, por që i përkasin kategorisë së pagave dhe mëditjeve;
- Dy pagesa në vlerë 39,080€ nga mallrat dhe shërbimet, i përkisnin investimeve kapitale pasi sipas natyrës kanë të bëjnë me permisim apo renovim të ndërtesave shëndetësore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pagesave dhe regjistrimit të shpenzimeve në kodet jo përkatëse ekonomike si dhe mungesës së një analize të natyrës së shpenzimeve nga ana e zyrtarit autorizues gjatë planifikimeve buxhetore.

**Ndikimi**

Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PFV.

**Rekomandimi B2**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë marrë masat e duhura që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ShSKUK-së, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Vlera jo të sakta të buxhetit të të hyrave në pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit**

**Gjetja** Neni 14 i Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore specifikon që Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit të përfshijë ekzekutimin e buxhetit dhe të prezantojë informata mbi buxhetin fillestar sipas Ligjit Vjetor të Buxhetit, buxhetin final sipas SIMFK-së, si dhe realizimin e buxhetit, duke përfshirë edhe krahasimin ndërmjet buxhetit final dhe realizimit.

Edhe pas kërkesës së ekipit të auditimit për korigjimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Hyrja e Parasë së gatshme, në vend të buxhetit fillestar dhe final për të hyrat jo tatimore, është prezantuar vlera e realizimit vjetor të këtyre të hyrave, duke mos reflektuar ndryshimet e kërkuara. Si rezultat, ekziston një diferencë prej 1,048,801€ ndërmjet të hyrave të buxhetuara dhe vlerës së raportuar.

Mangësitë e identifikuar kanë ndodhur si shkak i kontrolleve jo të duhura me rastin e përgaditjes dhe rishikimit të PFV-ve, si dhe mos zbatimit me përpikëri të kërkesave të rregullores për raportim financiar.

**Ndikimi** Prezantimi jo i drejtë i informatave lidhur me buxhetin fillestar dhe final të të hyrave jo tatimore ka ndikuar në nënvlerësimin e këtyre informatave në Pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit në PFV, duke ndikuar në besueshmërinë e pasqyrave financiare.

**Rekomandimi A1** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të mos dorëzohen pa iu nënshtruar më parë një rishikimi të detajuar nga menaxhmenti dhe zbatimit me përpikëri të kërkesave të rregullores për raportim financiar në mënyrë që mangësitë e tilla të mos përsëriten në vitet e ardhshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B3 - Pasaktësi në regjistrimin dhe raportimin e detyrimeve kontigjente në PFV**

**Gjetja** Rregullorja Nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, nenet 17 dhe 18 theksojnë se OB duhet të raportojnë në Pasqyrat Financiare Vjetore të gjitha detyrimet kontigjente, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen financiare të institucionit.

Regjistri i detyrimeve kontigjente ishte mbivlerësuar për 342,311€:

- Në dy raste në SHSKUK vlera e shpalosur e detyrimeve kontigjente ishte mbivlerësuar për 247,190€ krahasuar me vlerën reale të kontestit; dhe
- Një padi në SP Gjilan në vlerë 95,121€ vazhdonte të ishte pjesë e regjistrit të detyrimeve kontigjente të shpalosura ndonëse kontesti kishte përfunduar.

Më tutje, katër (4) raste ishin shpalosur në PVF pa vlerë financiare, ndërsa sipas dokumenteve burimore që posedonte SHSKUK vlera e tyre e përbashkët ishte 108,677€. Nga analiza e regjistrit të detyrimeve kontigjente rezultoi se nga 3,970 lëndë, rreth 16% e tyre (625 lëndë) nuk

kanë një vlerë financiare të përcaktuar.

Shpalosja jo e saktë e vlerave të detyrimeve kontigjente ishte si rezultat i mungesës së vlerësimit jo të duhur financiar dhe mos përditësimit të regjistrit në rastin kur paditë përfundojnë.

- Ndikimi** Kjo ka ndikuar në prezantimin jo të saktë të të dhënave në PFV duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e informacionit financiar të paraqitur për palët e mundshme të interesit.
- Rekomandimi B3** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmarrin masa për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme për detyrimet kontigjente (DK), si dhe të sigurohen se bëhet një përditësim periodik i regjistrit, në mënyrë që të ofrohet një pamje e qartë dhe e drejtë e gjendjes financiare të organizatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Përfshirja e artikujve me afat të skaduar në stokun farmaceutik**

- Gjetja** Rregullore Mf - Nr. 01/2017, nen 6 Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Në regjistrat e stokut farmaceutik figuronin shtatë (7) artikuj në vlerë të përbashkët 58,154€ të cilëve ju kishte kaluar afati i përdorimit gjatë vitit. Si rrjedhojë për të njëjtat nuk ishte bërë dalje si artikuj të skaduar në Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF). Kjo vlerë ishte përfshirë në raportin aktual të stoqeve të prezantuara në PFV.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së monitorimit të rregullt të afateve të skadencës së barnave në stok, po ashtu kontrollit të pa mjaftueshëm periodik të stokut për të siguruar që barnat me afat të skaduar të evidentohen dhe të trajtohen sipas procedurave përkatëse.

- Ndikimi** Mbajtja e barnave me afat të skaduar në stok ndikon në paraqitjen jo të saktë të vlerës së stokut në pasqyrat financiare duke i mbivlerësuar ato.
- Rekomandimi A2** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojë kontrollet për menaxhimin e stokut farmaceutik, duke siguruar se po realizohet monitorim i rregullt i afateve të skadencës së artikujve. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime për identifikimin dhe trajtimin e tyre sipas procedurave të brendshme.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mungesa e pasurisë**

- Gjetja** Sipas nenit 8 të Rregullores MF-Nr. 02/2013-për menaxhimin e pasurisë jo financiare- Pranimi i pasurisë jo financiare behet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga organizatat tjera buxhetore.

Për pasurinë "Kombi Bus-4 dyer" në vlerë origjinale prej 25,000€, e cila sipas regjistrimit i përket Spitalit të Prizrenit, nuk ishin siguruar evidenca që dëshmonin ekzistencën e sajë dhe së është në përdorim, apo se pasuria është tjetërsuar apo dhuruar. Për të njëjtën ishte raportuar edhe në raportet e dy viteve paraprake mirëpo gjendja në regjistra vazhdon të jetë e njëjtë.

Gjatë vitit 2025 Spitali i Përgjithshëm Prizren, kishte drejtuar kërkesë për inicim të rastit penal në Njësinë Rajonale për hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionin-Prizren.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së politikave të qarta për regjistrimin, verifikimin dhe mbajtjen e pasurisë. Po ashtu, për shkak të mungesës së përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Spitalit të Prizrenit për ofrimin e informatave mbi pasurinë që e mbajnë në regjistra dhe për identifikimin fizik të saj.

**Ndikimi**

Pamundësia për të dëshmuar ekzistencën fizike të pasurisë të cilën e mbanë në regjistra në mungesë të informatave për të njëjtën, rrit mundësinë e keqpërdorimit, humbjes apo tjetërsimit të saj.

**Rekomandimi B4**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë ashtu që të sigurojnë informata dhe dëshmi për ekzistencën fizike për të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Mbatja e pozitive të nivelit drejtues me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

**Gjetja** Ligji Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 9.2, përcakton se zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj, përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por pozita nuk është plotësuar për arsye objektive. Po ashtu, e njëjta dispozitë përcakton se pozita e lirë nuk mund të mbulohet me ushtrues detyre për më gjatë se dy (2) vite. Tutje neni 18 i po të njëjtit ligj, thekson së brenda afatit 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (qershor 2025) obligohen institucionet të përshtatin këto vendime në përputhje me nenin 35 të ligjit bazik.

Në programe të ndryshme në kuadër të SHSKUK-së janë identifikuar nëntë (9) pozita të nivelit drejtues të mbuluara me vendime për ushtrues detyre (UD) jo në përputhje me afatin e përcaktuar ligjor. Vendimet për këto pozita ishin që nga viti 2010 deri në 2023. Nga zyrtarët përgjegjës është konfirmuar që pozita të mbuluara me UD të cilat nuk ishin në përputhje me dispozitat ligjore ishin gjithsej 337.

Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme dhe në kohë për zhvillimin e procedurave të rregullta të rekrutimit dhe emërimit përmes konkurseve publike, po ashtu vendimet nuk ishin përshtatur sipas ndryshimit të dispozitave ligjore.

**Ndikimi** Mbulimi i pozitive të nivelit drejtues me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se periudha e lejuar krijon pasiguri në vendimmarrje dhe në përgjegjësitë e funksioneve kyçe.

**Rekomandimi A3** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të përshtat vendimet për ushtrues detyre në përputhje me dispozitat aktuale ligjore, si dhe të sigurojë që brenda një afati të arsyeshëm të zhvillojë procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore për plotësimin e pozitive që mbahen me ushtrues detyre.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

**Gjetja** LMFPP, neni 39.1 përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet të furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 21 raste, me vlerë të përgjithshme prej 5,890,791€, pagesat janë realizuar me vonesë, pasi faturat e pranuar nuk janë paguar brenda afatit të përcaktuar. Vonesat kanë qenë nga pesë (5) deri në 86 ditë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh për pagesë.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i menaxhimit joefikas të detyrimeve, mungesës së planifikimit adekuat të mjeteve financiare dhe dobësive në kontrollet e brendshme lidhur me procesin e pagesave.

**Ndikimi** Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë SHSKUK-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

**Rekomandimi B5** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin me fikas të detyrimeve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Vonesa në liferimin e aparaturave mjekësore dhe zgjatje e paautorizuar e afateve kontraktuale**

**Gjetja** Sipas nenit 2 të kontratave dhe kushteve të veçanta, është i përcaktuar qartë afati i liferimit të mallrave në ditë, i cili duhet të respektohet nga operatori ekonomik. Po ashtu, nenet 61.22, 61.23 dhe 61.24 të RrUOPP-së specifikojnë se, në rastin e ndryshimeve në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer, inicimi bëhet nga menaxheri i kontratës, ndryshimi përgatitet nga prokurimi ndërsa OE ndryshimi i kontratës nuk mund ti lëshohet pa marrjen e aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Në katër pagesa për blerje të aparaturave mjekësore në vlerë të përbashkët prej 927,200€, janë evidentuar vonesa në liferimin e mallrave përtej afateve të përcaktuara kontraktuale. Përkundër këtyre vonesave, nuk kemi gjetur dëshmi se janë aplikuar penalët e parapara me kontratë. Afatet e zgjatjes së kohës së liferimit ishin aprovuar nga Menaxheret e kontratave pa e marrë aprovimin e ZKA-së. Vonesat e identifikuara variojnë nga 3 ditë deri në 52 ditë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos respektimit të procedurave të përcaktuara për ndryshime kontraktuale dhe mungesës së monitorimit efektiv të zbatimit të kontratave.

**Ndikimi** Vonesat në liferimin e mallrave kanë ndikuar në mosrealizimin me kohë të aktiviteteve dhe projekteve të SHSKUK-së, ndërsa ndryshimi i kushteve kontraktuale pa autorizimet e duhura cenonë transparencën dhe menaxhimin e rregullt të kontratave.

**Rekomandimi A4** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë forcimin e kontrolleve të brendshme dhe monitorimin sistematik të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen në përputhje me kushtet kontraktuale. Në rastet e vonesave duhet të sigurohet aplikimi i penalevetë përcaktuara në kontratë, për të rritur llogaridhënien dhe respektimin e obligimeve kontraktuale.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A5 - Dhënia e avansit për investime kapitale përtej limiteve të përcaktuara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore**

**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025 neni 13 Pagesat e paradhënies pika 4 specifikon që në muajin dhjetor pagesa e paradhënies është e kufizuar në 5% të vlerës së kontratës.

SHSKUK, respektivisht Spitali i Përgjithshëm Prizren, ka ekzekutuar në muajin dhjetor pagesën në formë avansi prej 15% në vlerë prej 341,502€, për projektin "Renovimi dhe riorganizimi i reparteve pediatri dhe interno Spitali i Përgjithshëm". Ekzekutimi i avancit ishte paraparë në kontratë, ndonëse ekzekutimi ishte bërë në kundërshtim me kufizimet ligjore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimit të kontroleve në procesin e certifikimit dhe ekzekutimit të pagesës me ç'rast është lejuar ekzekutimi i pagesës duke mos u aplikuar kufizimet ligjore të fund vitit, duke u bazuar në kushtet e kontratës.

**Ndikimi**

Dhënia e avanseve në kundërshtim me kufizimet ligjore ekspozon buxhetin ndaj rrezikut të përdorimit jo të rregullt të fondeve publike.

**Rekomandimi A5**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se procesi i certifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për investime kapitale të bëhet duke respektuar kufizimet e përcaktuara në Ligjin e Buxhetit. Të sigurohet mbikëqyrje më rigoroze në procesin e autorizimit të pagesave, në mënyrë që të parandalohet dhënia e avanseve pa bazë ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 252,481,369€, pasurive jokapitale është 6,328,035€, si dhe e stoqeve 25,882,017€.

#### Çështja B6 - Funkcionalizimi jo i plotë i sistemit e-pasuria

**Gjetja** Sipas Rregullorës MF- nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare neni 6.3 parasheh se Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet në sistemin "e-pasuria".

Edhe përkundër rekomandimeve të dhëna ndër vite, SHSKUK, ende nuk ka arritur ta funksionalizoj sistemin e-pasurinë në të gjitha programet e saja.

- Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) nga gjithsej 45 klinika vetëm 22 prej tyre e kanë funksionalizuar sistemin e-pasuria;
- E-pasurinë nuk e kishin funksionalizuar as: Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë, Pejë, Gjilan, dhe Vushtrri, po ashtu Qendra për Integrim dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime, si dhe Qendrat e Shëndetit mendor. Prezantimi i pasurisë në PFV ishte bazuar në të dhëna nga Excel.

Kjo ka ndodhur si rezultat i përpjekjeve jo të mjaftueshme dhe mungesës së veprimeve të nevojshme për funksionalizimin e sistemit e-pasuria, si dhe mungesës së infrastrukturës së duhur në QKUK lidhur me pajisjet e nevojshme teknologjike.

**Ndikimi** Mos përdorimi i sistemit e-pasuria rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjen potenciale, keqpërdorimin, humbjen apo tjetërsimin e tyre.

**Rekomandimi B6** Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B7 - Mos-harmonizimi i regjistrave të inventarizimit me regjistrat e pasurive

**Gjetja** Sipas Rregullorës MF- nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 19, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare ndër të tjera janë: inventarizimi i të gjitha pasurive jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore; verifikim fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare; dhe krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Megjithëse, SHSKUK dhe njësitë vartëse kishin themeluar komisionet e inventarizimit dhe kishin filluar procesin e inventarizimit, ky proces nuk kishte filluar edhe në Depon Qendrore në SHSKUK. Raportet

përmbledhëse të komisioneve, në pjesën më të madhe, kishin formën e një “check-list”-e. Rrjedhimisht, nuk ishin përmbushur përgjegjësitë e komisioneve siç përcaktohen me rregullore, me ç'rast ishte pamundësuar harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Për më tepër, gjatë këtij auditimi në SHSKUK janë identifikuar mangësi lidhur me menaxhimin e pasurive, përfshirë mos regjistrimin e pasurive dhe gabime në regjistrim. Këto mangësi reflektojnë mungesën e një procesi efektiv të inventarizimit dhe harmonizimit me regjistrat përkatës, proces i cili do të mundësonte identifikimin dhe adresimin në kohë të problemeve, para se ato të ndikonin në pasqyrat financiare.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të neglizhencës dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

**Ndikimi**

Mos kryerja e inventarizimit sipas kërkesave të rregullores përkatëse mund të ndikojë në mos raportimin e saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

**Rekomandimi B7**

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se sistemi i vendosur i kontrollit është mjaftueshëm efikas dhe siguron se po kryhet procesi i inventarizimit periodik të pasurisë sipas kërkesave të rregullores në fuqi në mënyrë që të kemi një raportim të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

#### Çështja 1 **Kalkulim jo i duhur i shtesave të kujdestarive për ditën e premte**

##### Gjetja

Si rezultat i kompensimit të kujdestarive të ditës së premte me normën prej 150% të pagës bazë (si kujdestari të fundjavës), për periudhën janar-korrik 2025 janë ekzekutuar shpenzime shtesë prej 231,604€ në të gjitha njësitë e SHSKUK-së.

##### Veprimi i kërkuar

Rekomandimi i dhënë në raportin e auditimit për vitin 2024 theksonte nevojën për ndërmarrjen e masave për konfirmimin e kalkulimit të kompensimit të kujdestarive.

##### Rezultati

Pas pranimit të Raportit final të Auditimit, janë ndërmarrë veprime korrigjuese të cilat kanë pasur efekt në kalkulimin e kompensimit nga muaji gusht 2025.

#### Çështja 2 **Paraqitje jo e saktë e informatave në Pasqyrat Financiare**

##### Gjetja

Gjatë rishikimit të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), krahasimit me buxhetin dhe shpenzimet, si dhe shqyrtimit të shënimeve shpjeguese, janë identifikuar disa mospërputhje si në vijim:

- Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare 2, 3 dhe 6: mungonin shpenzimet e kategorive përkatëse të shpalosura sipas burimit të financimit, ndërsa shuma e paraqitur si buxhet final i përket buxhetit fillestar (diferencat në buxhetin final sipas shënimeve ishin: kategoria e pagave nënvlerësim për 4,419,233€, kategoria e mallrave nënvlerësim për 9,874,946€ ndërsa kategoria e investimeve kapitale mbivlerësim për 1,263,267€);
- Shënimi 9 - Të hyrat jo tatimore: shuma krahasuese për vitin 2023 është nënvlerësuar për 3,498,769€ për shkak të gabimeve teknike në prezantimin e shifrave;
- Neni 19.3.2 - Pasuria jokapitale (nën 1,000€): ishte mbivlerësuar për 1,856,173€ për shkak të mangësive në konsolidimin e të dhënave me shënimet e programeve në kuadër të SHSKUK-së;
- Neni 19.3.3 - Stoqet: ishin nënvlerësuar për 21,426,489€ për shkak të mangësive në konsolidimin e të dhënave me shënimet e programeve.

<b>Veprimi i kërkuar</b>	Rishikimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2025, i kryer nga ekipi i auditimit, ka nxjerrë në pah nevojën për korrigjimin e tyre, me qëllim sigurimin e paraqitjes së drejtë dhe të besueshme të vlerave financiare, duke marrë parasysh ndikimin material të identifikuar.
<b>Rezultati</b>	Kjo çështje është korrigjuar nga SHSKUK, pas konsultimeve me ekipin e auditimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ministria e Financave.

### Çështja 3 Pasaktësi në realizimin e pagesës përbarimore

<b>Gjetja</b>	Një pagesë e realizuar me vendim përbarimor nga Thesari në vlerë prej 207,951€, ishin paguar mjete me teper pasi në listën e debitorëve ishte përfshirë një shumë prej 37,312€, detyrim ky që nuk i takonte SHSKUK-së.
---------------	--

<b>Veprimi i kërkuar</b>	Rishikimi i pagesave të bëra me vendime përbarimore kryer nga ekipi i auditimit, ka nxjerrë në pah nevojën për korrigjimin e këtij shpenzimi dhe kthimin e mjeteve të cilat nuk kishin të bënin me SHSKUK-në.
<b>Rezultati</b>	Pas ndërmarrjes së veprimit për korrigjim, në nëntor të 2025 është bërë kthimi i mjeteve në llogarinë e Thesarit.

## 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>7</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>190,656,752</b>	<b>203,687,664</b>	<b>197,161,734</b>	<b>170,460,810</b>	<b>154,716,693</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	190,656,752	203,685,110	197,161,734	170,348,877	148,110,128
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	6,605,585
Donacionet vendore	0	113	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	2,441	0	111,933	980

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ka shënuar rritje prej 13,030,912€, si rezultat i ndryshimeve buxhetore të aprovuara përmes vendimeve të Qeverisë.


SHSKUK ka shpenzuar buxhetin e vitit 2025 në nivel prej 97%, që paraqet një nivel të ngjashëm me vitin paraprak.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>190,656,752</b>	<b>203,687,664</b>	<b>197,161,734</b>	<b>170,460,810</b>	<b>154,716,693</b>
Pagat dhe mëditjet	94,561,890	98,981,123	98,975,903	89,971,846	84,532,481
Mallrat dhe shërbimet	69,506,346	79,381,292	76,487,721	63,711,039	58,769,656
Komunalitë	4,139,016	4,139,016	4,095,880	3,626,047	4,175,220
Investimet Kapitale	22,449,500	21,186,233	17,602,230	13,151,879	7,239,337

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar, ishte rritur për 4,419,233€, si rezultat i rritjes së njësisë së koeficientit të pagave për 0.5, që rrjedhimisht ka ndikuar edhe në rritjen e vlerës së kujdestarive. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar, ishte rritur për 9,874,946€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 96%.
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,263,267€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit. Në listën e projekteve janë renditur 23 projekte; dy nga këto nuk kanë realizuar asnjë shpenzim, gjë që ka ndikuar në shkurtimet buxhetore. Realizimi i kësaj kategorie ishte 83%.

**Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025**



Të hyrat e realizuara nga SHSKUK në 2025 ishin në vlerë 3,123,932€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga participimi, certifikatat mjekësore, parkingu etj.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>4,172,733</b>	<b>4,172,733</b>	<b>3,123,950</b>	<b>3,502,065</b>	<b>3,759,915</b>
Të hyrat jo tatimore	4,172,733	4,172,733	3,123,932	3,501,459	3,759,915
Të hyrat tjera	0	0	18	606	


## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të SHSKUK ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. SHSKUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, dy (2) rekomandime janë zbatuar si dhe shtatë (7) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Krahasuar me vitin e kaluar gjendja e implementimit të rekomandimeve mbetet po thuajse e njëjtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2025 ka mbivlerësim të pasurive në regjistra.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë marrë masat e duhura që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e SHSKUK-së, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2025 kishte raste të keq klasifikimit të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë ashtu që të sigurojnë informata dhe dëshmi për ekzistencën fizike për të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.	Rasti është paraqitur në njësinë për hetime në kuadër të Policisë së Kosovës mirëpo nuk ka ndonjë rezultat ende.	Nuk ka filluar zbatimimi
4.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë bërë analiza për vlerësimin e ndikimit të kësaj çështje edhe në programet tjera të ShSKUK-së, si dhe janë ndërmarrë masa që të sigurojnë që kalkulimi i shtesës për kujdestarin e ditës së premtë të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Pjesa e kujdestarive të ditës së premtë është korrigjuar nga të gjitha njësitë në pjesën e dytë të vitit.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë koordinimin më efektiv ndërmjet programeve dhe të vendosen mekanizma të duhur për konsolidimin e të dhënave financiare. Po ashtu, të kryhet verifikim i plotë dhe i detajuar i pasqyrave financiare përpara dorëzimit të tyre, me qëllim të sigurimit që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar. Si dhe, të ndërmarrë masa për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme për detyrimet kontigjente, në mënyrë që të ofroj një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.	Edhe gjatë këtij viti kemi vërejtur se raportimet nuk ishin të sakta, për shkak se detyrimet kontingjente dhe pasuria nuk ishin paraqitur drejt.	Nuk ka filluar zbatimimi
6.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.	Edhe gjatë vitit 2025 ka pasur raste kur faturat e pranuar nuk janë paguar me kohë.	Nuk ka filluar zbatimimi
7.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të sigurohen se anëtarët e komisioneve vlerësuese konsiderojnë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu, të sigurohen kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe në zyrën e prokurimit me qëllim që të evitohet përdorimi i kritereve të paqarta me rastin e hartimit të specifikave teknike.	Gjatë testimit të pajtueshmërisë këtë vit, nuk kemi identifikuar asnjë parregullsi.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se sistemi i vendosur i kontrollit është mjaftueshëm efikas dhe siguron se po kryhet procesi i inventarizimit periodik të pasurisë sipas kërkesave të rregullores në fuqi në mënyrë që të kemi një raportim të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.	Në disa programe dhe njësi të SHSKUK-së edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur probleme me procesin e inventarizimit.	Nuk ka filluar zbatimimi

9.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2025 nuk kishte funksionalizuar sistemi e-pasuria në të gjitha programet e sajë.	Nuk ka filluar zbatimin
----	----------	--	--	-------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Mirlinda Beqiri, Udhëheqëse e ekipit



Jehona Krasniqi Rexha, Anëtare e ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

Republika e Kosovës / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI PËR SHËNIMIN: 29-05-2026			
Mësimi Org. Org. Jedm. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	870	1

No. i kopjeve të orig. god. orig. list.	No. i zën. Br. list. No. page	No. i list. Br. list. No. page	Data Date
1	1	1	29.05.26

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, për vitin 2025;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Elvir Azizi

Drejtor i Përgjithshëm në Shkëlqim

Data: 29.05.2026



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>8</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> 1. Fatura në vlerë 528,000€ për kontratën “furnizim dhe instalimin e pajisjeve dhe shtretërve për hemodializë për klinikën e nefrologjisë” është regjistruar vetëm 265,500€ 2. Fatura në vlerë 98,800€ për kontratën “furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e njësisë të SHSKUK lot 2” ishte regjistruar vetëm 32,600€ 3. Fatura në vlerë 125,930€ për kontratën “Furnizim me aksesori instrumente dhe material për neuroskop” ishte regjistruar vetëm 31,160€
- <sup>6</sup> Këto raste janë vërejtur në kontratat për furnizim me “Digital C-Arm System”, “Endoscopie Flexible system for Gastro and Colonoscopy- complete” “Sistemi komplet 4K për Laparaskopi” si dhe “Electrical Operating Table for General Surgical procedures dhe Surgical Light for Operating Rooms”.
- <sup>7</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>8</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>9</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.